

[Data 26/10/2022]

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Rioptimizimi dhe Standartizimi i Proceseve të punës të strukturës së institucionit të Bashkisë Tiranë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 72330000-2

Vlera e Fondit Limit: 62,500,000 (gjashtëdhjetë e dy milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH ose 529,795.711 (pesëqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë, pikë shtatëqind e njëmbëdhjetë) Euro pa TVSH.

** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 26/10/2022 është 117.97 Lekë/Euro*

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të V.K.B-së Nr.166, datë 24.12.2021 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2022”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të shërbimeve, specifikimeve teknike/Termave të Referencës, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi do e bënte shumë të vështirë për tu menaxhuar.

Kjo procedurë shërbimi duhet të kryhet në një lot të vetëm, pasi lloji i shërbimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik. Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës që ky shërbim ka. Ndarja në lote do të sillte konfuzion pasi të gjithë zërat e kërkuar për ofrimin e shërbimit janë procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndarja e tyre në lote do të sillte crregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të shërbimit si dhe kosto shtesë për AK. Të gjithë zërat e artikujve të shërbimit që

do ofrohen për zhvillimin e proceseve sipas kërkesave të AK janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, pra janë të gjithë si një komponent i vetëm në funksion të njëra tjetrës.

Në këto kushte, duke qënë se kemi të bëjmë me një familje artikujsh të vetëm dhe si i tillë nuk pengon operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procedurën objekt prokurimi gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit.

Për këtë arsye, është e pamundur që zërat e shërbimeve të ndahen në grupe ose vec e vec secili, pasi do të vështirësonte realizimin e kontratës, rrjedhimisht nga mundësia e lidhjes së kontratës me disa operatorë ekonomikë të ndryshëm, ndaj AK ka vendosur që këtë procedurë ta zhvillojë pa e ndarë në lote.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin Vërtetim nga Drejtoria Tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiar. Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros për të paktën një nga tre vitet e fundit financiar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;". Kjo procedurë është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 OE, duhet të jetë në zotërim të certifikatave kundrejt standarteve ISO 9001:2015 “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, Për të vërtetuar sa më sipër OE do të duhet të paraqesë Certifikatat e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të akredituara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH. Në rastet e bashkimit të operatoreve secili OE duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

a) ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë;

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e akreditimit të vlefshme për qëllimin ISO CERTIFICATION për “Administratën Publike” (kodi EA36) lëshuar nga një Trupë Certifikuese, pjestare e “The International Accreditation Forum” (IAF).

Argumentimi: *Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet: 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; 23 ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...

Certifikimi ISO kodi EA 36 është pjesë e grupit ISO 9001 e cila ndan dhe specifikon tregun në 39 sektorë, (kodi 36) i përket Sektorit të Administrimit Publik. Operatori Ekonomik duhet të zotërojë certifikimin me (kod 36) për të vërtetuar dhe dëshmuar se mbajtësi i saj garanton standartet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit në sektorin e Administrimit Publik. Me plotësimin e kësaj kërkeses AK vlerëson se OE është i aftë dhe i certifikuar për të vlerësuar sistemin e menaxhimit të administratës publike, kompetencën/ profesionalizmin e punonjësve të administratës publike si dhe sugjerimin e veprimeve korigjuese. Ky certifikim kërkohet të jetë i lëshuar nga një trupë certifikuese pjesë e IAF. Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit (IAF) është një shoqatë mbarëbotërore e organeve të akreditimit dhe organeve të tjera të interesuara në vlerësimin e konformitetit në fushat e sistemeve të menaxhimit, produkteve, proceseve, shërbimeve, personelit, vlefshmërisë dhe verifikimit dhe programeve të tjera të ngjashme të vlerësimit të konformitetit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë patur përvojë të mëparshme në certifikimin e sistemeve të menaxhimit të cilësisë duke u bazuar në kërkesat e standartit ISO 9001:2015 në të paktën 3 (tre) organizata me kodin (EA36).

Vërtetime të pikave **2.3.3** dhe **2.3.4**

- Kopje të noterizuar të certifikatës së Akreditimit

- Listë Referencash për 3 (tre) organizatat e kërkuara më sipër shoqëruar me kopie të kontratave/ose faturave të noterizuara, bazuar në kërkesat e standartit ISO 9001:2015, kodi EA36.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 1/a dhe c "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; dhe c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.....pika 2. "Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."....., pika 4. "Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën."

si dhe në mbështetje të nenit 41, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Kriteret e kualifikimit vendosën që ti shërbejnë AK-së, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE-ve, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme si aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe cdo element tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, Operatorët Ekonomikë, që të vërtetojnë se kanë një nivel të mjaftueshëm përvojë mund të paraqesin **referenca të përshatshme** nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Është në të drejtën e AK-së të kërkojë listë referencash për 3 (tre) organizatat e kërkuara më sipër shoqëruar me kopie të kontratave/ose faturave të noterizuara, bazuar në kërkesat e standartit ISO 9001:2015, kodi EA36 që vërtetojnë pajtueshmërinë me specifikimet teknike të vendosura, përpara se AK të bëjë përzgjedhjen e OE fitues. Kjo kërkesë është në përputhje me nenin 44 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

Duke ju referuar kompleksitetit të institucionit dhe termave teknik për të vërtetuar kapacitetin teknik të operatorit një numër prej 3 referencash nga organizata me kodin (EA 36) konsiderohet si i mjaftueshem për të vërtetuar profesionalizmin dhe eksperiencën e një trupe certifikuese ISO 9001:2015, kodi EA 36

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, për të garantuar implementimin me sukses të projektit, duhet të ketë në përbërje staf pune punonjës të specializuar/të kualifikuar, ekspertë të fushës me eksperiencë prej mbi tre vite, nga të cilët të paktën njëri duhet të zotërojë certifikimet/ kualifikimet e mëposhtme:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, gërma b dhe c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për tre punonjës të kualifikuar i garanton autoritetit të drejtojë prioritetet e tij duke i orientuar ato drejt përdorimit më të mirë të burimeve, duke arritur misionin, qëllimet dhe objektivat e kontratës në tërësi. Të paktën 3 vite eksperiencë pune në sektor janë të rëndësishme pasi ekspertët duhet të dëshmojnë një sërë aftësish dhe një nivel pjekurie të caktuar në menaxhimin e prioriteteve të kontratës dhe planifikimit eficient. Njohuritë në fushat përkatëse ndihmojnë në menaxhimin e kërkesave dhe të punëve në përmbushje të detyrimeve që lindin nga zbatimi i kontratës dhe rezultatet që priten të arrijë AK nëpërmjet këtij shërbimi. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejtë me objektin e kontratës dhe është garanci për përmbushjen e saj

Tre punonjës të punësuar në listëpagesë nga të cilët të paktën njëri zotëron certifikimet që lidhen ngushtësisht me zbatimin e kontratës, është numri optimal që garanton cilësinë e zbatimit të specifikave teknike të projektit. Gjithashtu marrë në konsideratë numrin e institucioneve të përfshira në projekt është i konsiderueshëm dhe për implentimin e saktë të procedurave për rioptimizimin dhe standartizimin e proceseve të punës, numri i vendosur i punonjësve Teknik konsiderohet si i domosdoshëm.

Numri i personave të stafit të kërkuar është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë projekt. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës bazuar në analizën e kryer për kërkesën për punonjës të specializuar/të kualifikuar, konkretisht:

1. Të paktën 1 (një) punonjës të diplomuar në nivel min Master në fushat e ngjashme me shërbimet e kërkuara si, Menaxhim i cilësisë/ Kërkime Operacionale në Menaxhim/ Menaxhim Projektesh apo të ngjashme me to. Diploma përkatëse e noterizuar.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

Është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për realizimi me sukses të projektit, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili t'i përgjigjet më së miri nevojave të tij për përmbushjen e projektit.

Kërkesa për punonjës me edukim Master në fushën e Menaxhimit, gjykojmë se është e bazuar dhe e lidhur ngushtësisht me realizimin e kontratës duke garantuar përmbushjen e të gjitha funksionalitetet dhe kërkesat e sipërcituara pjesë e termave të referencës.

Studimet akademike Master në Menaxhim është diplomë që fokusohet në sistemet e cilësisë, zhvillimin e menaxhimit dhe përmirësimin e cilësisë, përfshin të mësuarit për mjediset ndërkombëtare të biznesit, financat, menaxhimin e njerëzve, Manaxhimit të burimeve njerëzore dhe karrierës të organizatave publike, planifikimin e performancës dhe krijimin e sistemeve të menaxhimit të qëndrueshëm. Koniderohet domosdoshmëri për shkak të sigurisë profesionale që ofron në përgatitjen e një metodologjie për menaxhimin e procesit dhe vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë; Vlerësimi i sistemit të menaxhimit të procesit dhe menaxhimit të cilësisë sipas metodologjisë së përcaktuar; Krijimi i raporteve me dobësitë e identifikuara dhe rekomandime për trajnime për përmirësimin e procesit.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë që ka ky projekt që reflektohet jo vetëm në vlerën por dhe shtrirjen e institucioneve të përfshira në proces, për Autoritetin Kontraktor është shumë e rëndësishme që O.E të ketë në staf persona të aftë për ta menaxhuar projektin në tërësi nga ana e Menaxhimit të Cilësisë.

2. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Krye zbatues, Lead Implementer të ISO 9001 (Certified ISO 9001 Lead Implementer). Certifikata e noterizuar.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

Standardi ISO 9001 kërkon që organizatat të vendosin Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për të rritur efikasitetin e proceseve dhe për të përmbushur nevojat e klientëve. Mbjatësit e Certifikimit të zbatuesit kryesor (lead implementor) ISO 9001 zotërojnë aftësitë e projektimit, zbatimit, mirëmbajtjes dhe menaxhimit të SMC (sistemit të menaxhimit të cilësisë) sipas standardit ISO 9001.

Certifikata si Lead Implementor të ISO 9001, vërteton aftësitë e punonjësit lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, vërteton ekspertizën e nevojshme për të mbështetur një organizatë në krijimin, zbatimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e një Sistemi të Menaxhimit të Cilësisë (QMS) bazuar në ISO 9001, kërkesë kjo teknike e kësaj procedure.

Kërkesa për punonjës me Certifikatë të vlefshme për Krye zbatues, Lead Implementer të ISO 9001 (Certified ISO 9001 Lead Implementer), gjykojmë se është e bazuar dhe e lidhur ngushtësisht me realizimin e kontratës duke garantuar përmbushjen e të gjitha funksionalitetet dhe kërkesat e sipërcituara pjesë e termave të referencës.

Kjo certifikatë lëshohet nga organizma certifikuese që ofrojnë programe edukimi, certifikimi kundrejt standarteve rigorozë të njohura ndërkombëtarisht. Pasja e një certifikimi nga ky institucion është një siguri më shumë për zbatimin brenda standarteve sistemin ISO 9001 në Administratën Publike të Bashkisë Tiranë.

Është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për realizimi me sukses të projektit, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili t'i përgjigjet më së miri nevojave të tij për përmbushjen e projektit.

3. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Lead Auditor për ISO 9001 (Certified ISO 9001 Lead Auditor). Certifikata e noterizuar

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

Nëpërmjet kërkesës së mësipërme, Autoriteti Kontraktor kërkon të vërtetojë që punonjësit me certifikimin Lead Auditor, pjesë e stafit teknik të operatorit ekonomik, kanë aftësi të planifikojnë, të udhëheqin, të raportojnë dhe të auditojnë sistemet e menaxhimit të organizatës/ institucionit në funksion të shërbimit që do të ofrohet duke aplikuar standarte, procedura, parime dhe teknika, si dhe të garantojë që shërbimi është konform standardeve të menaxhimit të cilësisë, dhe si i tillë mund të menaxhojë në mënyrë të sigurtë informacionin e kërkuar.

Kërkesa për një person të pajisur me certifikatën Lead Auditor për ISO 9001 është e domosdoshme për garantimin e kryerjes së procesit të auditimit të sistemit të cilësisë pasi ai është ndërtuar nga operatori ekonomik sipas kërkesave teknike të kësaj procedure. Kjo certifikatë duhet të jetë e lëshuar nga një institucion i akredituar për kryerjen e këtij Certifikimi.

Është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për realizimi me sukses të projektit, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili t'i përgjigjet më së miri nevojave të tij për përmbushjen e projektit.

Kërkesa për punonjës personel me certifikatë të vlefshme për Lead Auditor për ISO 9001, gjykojmë se është e bazuar dhe e lidhur ngushtësisht me realizimin e kontratës duke garantuar përmbushjen e të gjitha funksionalitetet dhe kërkesat e sipërcituara pjesë e termave të referencës.

4. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Lean Six Sigma Black Belt ose ekuivalente. Çertifikata e noterizuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për realizimi me sukses të projektit, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili t'i përgjigjet më së miri nevojave të tij për përmbushjen e projektit.

Specialisti i pajisur me certifikatën Lean Six Sigma Black Belt është një profesionist i përgatitur në metodologjinë DMAIC (Përcakto, Mat, Analizo, Përmirëso dhe Kontrolllo) i cila i referohet një cikli përmirësimi të drejtuar nga të dhënat që përdoret për përmirësimin, optimizimin dhe stabilizimin e proceseve dhe modeleve të një institucioni apo organizate. Personi i pajisur me këtë certifikatë është në gjendje të drejtojë në mënyrë profesionale projekte komplekse përmirësimi të dhe do të ofrojë sipas termave teknike Trajnim për Metodologjinë e Përmirësimeve të Procesit, në zbatim të fazës së dytë të kërkesave teknike të shërbimit të kërkuar.

Six Sigma është një metodologji që përdor mjete dhe koncepte statistikore për të identifikuar variacionet ose defektet në një proces. Një Certifikim i Akredituar Six Sigma në Menaxhimin e Zinxhirit të Furnizimit tregon se një individ ka arritur një nivel të veçantë njohurish në studimin dhe zbatimin e kësaj metodologjie. Programi i “Rripit të zi” ofron trajnim të avancuar në proceset teknike të përmirësimit dhe bazohet në parimet e Lean Six Sigma, duke mësuar si të rrisin produktivitetin, rrjedhën e procesit, duke ulur defektet totale, menaxhimin e kohës, etj.

Kërkesa për punonjës të certifikuar me Lean Six Sigma Black Belt, gjykojmë se është e bazuar dhe e lidhur ngushtësisht me realizimin e kontratës duke garantuar përmbushjen e të gjitha funksionalitetet dhe kërkesat e sipërcituara pjesë e termave të referencës.

5. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si KPI Key Performance Indicator Practitioner. Çertifikata e noterizuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Specialisti i certifikuar si KPI (Key Performance Indicator) practitioner do të projektojë dhe implementojë zgjidhje të posacme në infrastrukturën e sistemit si psh: mundësimi i vendosjes së

afateve për raportim të të dhënave nga strukturat raportuese, arritje të objektivave brenda afateve të caktuara, vlerësim të progresit dhe njohurive për të marrin vendime më të mira, etj.

Specialisti i certifikuar si KPI (Key Performance Indicator) practitioner do të kryej zhvillimin dhe matjen e performancës si dhe identifikimin e treguesve më kuptimplotë dhe të dobishëm të suksesit të institucionit pas kryerjes së trajnimeve të fazës së dytë të termave Teknik. Sipas pikës 3 të fazës së dytë, specialisti i certifikuar si KPI Practitioner do të kryejë Trajnim për vlerësimin e përmirësimeve duke përdorur Treguesit Kyç të Performancës (KPI) të lidhur me drejtuesit e Insitucionit të Bashkisë Tiranë me një kohëzgjatje minimale prej 16 orësh. Pas përfundimit me sukses të trajnimit dhe kalimit të provimit me shkrim, ofertuesi i shërbimit është i detyruar t'u lëshojë certifikata pjesëmarrësve në trajnim;

Kjo certifikatë duhet të jetë e lëshuar nga një institucion i akredituar me të karakteristika të ngjashme të akredituar për kryerjen e këtij Certifikimi.

Është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për realizimi me sukses të projektit, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili t'i përgjigjet më së miri nevojave të tij për përmbushjen e projektit.

Kërkesa për punonjës të certifikuar si KPI practiconer, gjykojmë se është e bazuar dhe e lidhur ngushtësisht me realizimin e kontratës duke garantuar përmbushjen e të gjitha funksionalitetet dhe kërkesat e sipërcituara pjesë e termave të references.

6. Të paktën 1 (një) punonjës i cili të ketë zbatuar të paktën 5 (pesë) projekte të përmirësimit të proceseve të biznesit ose përmirësimit të organizatës, nga të cilat të paktën 3 (tre) projekte të jenë në sektorin publik ose administratën publike. Vërtetim nga institucione/dhe ose kontratë që ka qenë pjesëmarrës/se në projektet e sipërpërmendura.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenit 41, pika 4/ b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose....., si dhe pika 6 “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*

Është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për realizimi me sukses të projektit, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili t'i përgjigjet më së miri nevojave të tij për përmbushjen e projektit.

Operatori ekonomik për të vërtetuar eksperiencën dhe profesionalizmin e tij në këtë fushë do të duhet të paraqesë të paktën 5 dëshmi të përmirësimit të procesve të organizatës nga të cilat 3 të dedikuara në sektorët publik apo administratë publike. Këto dëshmi përbëjnë garanci për realizimin me sukses të një projekti të tillë kompleks i cili përfshin jo vetëm Bashkinë Tiranë por edhe insititucionet e varësisë.

7. 1 (një) Ekspert si menaxher i cilësisë i organizmit inspektues sipas certifikatës së akreditimit, me të paktën 10 (dhjetë) eksperiencë si specialist/ auditues ose ekuivalent me standartin ISO 9001 në fushën e menaxhimit të cilësisë.

Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime.

Për të vërtetuar përmbushjen e kriterit 2.3.4/ pika 1-9, kualifikimet, eksperiencën e punës dhe profilet e stafit të specialistëve/ ekspertëve si më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin justifikues, si më poshtë:

- Deklaratë për stafin përgjegjës/ ekspertët e fushës
- Diplomë në fushat përkatëse të kërkuar,
- Certifikata / kualifikime profesionale në fushat përkatëse të kërkuara
- Librezë pune
- Kontratën/ kontratat e punës
- Listëpagesat sipas formularit eSig25 për tre muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

Është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për realizimi me sukses të projektit, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili t'i përgjigjet më së miri nevojave të tij për përmbushjen e projektit.

Menaxhimi i cilësisë është akti i mbikëqyrjes së aktiviteteve dhe detyrave të ndryshme brenda një organizate për të siguruar që produktet dhe shërbimet e ofruara, si dhe mjetet e përdorura për t'i ofruar ato, janë konsistente. Ajo ndihmon për të arritur dhe për të mbajtur një nivel të dëshiruar të cilësisë brenda organizatës.

Menaxherët e cilësisë synojnë të sigurojnë që produktet ose shërbimet që ofron një organizatë janë të përshtatshme për qëllimin, në përputhje me ligjin dhe përmbushin pritjet e klientit. Menaxheri i cilësisë do të koordinojë aktivitetet e kërkuara për të përmbushur standardet e cilësisë të vendosura për produkte ose shërbime të caktuara. Do të siguroj që kjo cilësi të jetë e qëndrueshme dhe të plotësojë kërkesat e jashtme dhe të brendshme. Ndër të tjera do të kryej Monitorime dhe këshillimin mbi performancën e sistemit të menaxhimit të cilësisë, prodhimin e të dhënave dhe raportimin mbi performancën, matjen me standardet e përcaktuara. Ata zhvillojnë dhe zbatojnë teste të kontrollit të cilësisë për të siguruar që rezultati i organizatës është ai kërkohet, duke inspektuar në faza të ndryshme projektin dhe duke shkruar raporte mbi gjetjet e tyre për të ndërmarrë veprime aty ku është e nevojshme.

Menaxheri i Cilësisë duhet të jetë me eksperiencë 10 vjecare për shkak të përgjegjësisë dhe rolit kyc që ka në këtë proces. Menaxheri i Cilësisë është përgjegjës për zbatimin dhe ekzekutimin e metodave të inspektimit, testimit dhe vlerësimit për të siguruar që produktet i përmbahen ngushtë standardeve, si dhe do të përgatisë një metodologji për menaxhimin e procesit dhe vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë;

Pra personi i pajisur dhe certifikuar si Menaxher cilësie si më sipër do të jetë pika kyçe që do të koordinojë të gjithë projektin dhe do të mbajë kontaktet me AK.

Do të jetë përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti implementimi, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, testimi, trajnimit dhe deri në fazën finale të certifikimit.

Metodologjia për vlerësimin e nivelit të Menaxhimit të Procesit dhe Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, do të përfshijë të gjitha aspektet domethënëse të problematikave të mundshme dhe hapësirën për përmirësime të sistemit ekzistues të menaxhimit.

Metodologjia për të vlerësuar se në çfarë niveli është Menaxhimi i Proceseve dhe Sistemi i Menaxhimit të cilësisë së Institucionit të Bashkisë Tiranë duhet të përfshijë cdo aspekt sinjifikativ të një rendësie të vecantë duke studiuar të gjitha pikat e mundshme të dobta të këtij procesi si dhe hapsirat potenciale për përmirësim të sistemit aktual të menaxhimit të proceseve.

2.3.6 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, duhet ketë në dispozicion burime njerëzore të mjaftueshme prej minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) personave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore (e-Sig02/a) ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, sipas legjislacionit në fuqi, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12, pjesa III, pika B.

b) Listëpagesat sipas formularit e Sig25 për tre muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12, pjesa III, pika B.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...]

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 41, pika 4.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- b) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të

prokurimit; dhe/ose

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf, jo më pak se 15 punonjës, është minimalisht e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës bazuar në analizën e kryer për kërkesën për punonjës të specializuar/të kualifikuar referuar kriterit 2.3.5. Gjithashtu referuar kompleksitetit të kontratës, kohëzgjatjes dhe proceceve të veprimtarive të shërbimeve që kërkohen të realizohen nga ky projekt, është e nevojshme që OE të ketë në dispozicion punonjës të cilët do të konsiderohen si staf në pozicione mbështetëse, si përpunues databaze, kordinator projekti, kordinator trainimi, përpunues dokumentacioni. Duke qenë se janë disa institucione të përfshira në këtë projekt, koordinatore të projektit do të jenë nga një prezent në çdo institucion përgjatë gjithë kohëzgjatjes së tij.

Numri i personave të stafit të kërkuar është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë projekt.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

2.3.7 Operatori ekonomik për të realizuar në mënyrën e duhur objektin e kësaj procedure duhet të ketë mbështetjen e duhur të programeve kompjuterike, softuer të mbështetjes së sistemit të menaxhimit në përputhje me standardin ISO 9001 me minimalisht funksionalitetet (modulet) e mëposhtme:

- Konteksti i organizatës,

- Objektivat dhe planifikimi për t'i arritur ato,
- Veprime për të trajtuar rreziqet dhe mundësitë,
- Punonjës & Trajnime
- Sistemi i Menaxhimit të Dokumenteve – DMS,
- Kontrolli i gjendjeve jo konforme & Veprimet korigjuese,
- Monitorime dhe matje,
- Shqyrtim Manaxherial,
- Detyra të tjera

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Përshkrimin e plotë i zgjidhjes së softwerike.
- Nje link te versionit demo të zgjidhjes softwerike.
- Dëshmi që operatori ekonomik është shpërndarës i autorizuar i kesaj zgjidhje softwerike

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” [...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie...] me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë burimet e nevojshme teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Mbështetja e përshtatshme softuerike konsiderohet të jetë: Operatori ekonomik zotëron një softwere mbështetës të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë gjithëpërfshirës i cili konsiderohet si një zgjidhje profesionale e projektuar për zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi menaxhimi si dhe optimizon performancën e përditshme. Softweri i mbështetjes së sistemit të menaxhimit duhet të jetë në përputhje me standardin ISO 9001 kështu që si minimum duhet të ketë funksionalitetet (modulet) e mëposhtme:

- Konteksti i organizatës,
- Objektivat dhe planifikimi për t'i arritur ato,
- Veprime për të trajtuar rreziqet dhe mundësitë,
- Punonjës & Trajnime
- Sistemi i Menaxhimit të Dokumenteve – DMS,
- Kontrolli i gjendjeve jo konforme & Veprimet korigjuese,
- Monitorime dhe matje,
- Shqyrtim Manaxherial,
- Detyra te tjera

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Përshkrimin e plotë i zgjidhjes së softwerike.
- Nje link te versionit demo të zgjidhjes softwerike.
- Dëshmi qe operatori ekonomik është shpërndarës i autorizuar i kesaj zgjidhje softwerike

Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Termat e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve

teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Bashkia e Tiranës është një institucion në përballje të vazhdueshme me ndryshime dinamike, zhvillimore, teknologjike dhe të normave dhe legjislacioneve përkatëse. Optimizimi dhe Standartizimi i Proceseve të Punës së strukturave të stafit të saj është e domosdoshme të kryhet në periudha të caktuara. BT ka kryer deri në këtë moment një evidentim të shumicës së proceseve të punës të cilat janë përkthyer në struktura konkrete me të cilat operon. Me qëllim për të patur një streamline sa më të saktë të proceseve të punës së institucionit dhe që këto procese të funksionojnë gjithmonë për të patur një efikasitet maksimale në kryerjen e punës dhe në ofrimin e një shërbimi sa më cilësor të qytetarëve të Bashkisë Tiranë. Eficenca ka një impakt të drejtëpërdrejtë mbi produktivitetin e punonjësve që do të përdorin këto procese. Nëpërmjet përmirësimit të tyre dhe rioptimizimit kërkohet të maksimizohet struktura me të cilën funksionon institucioni i BT dhe në të njëjtën kohë të trajnohen stafet që i përdorin këto procese, të rritet efikasiteti organizativ duke i përmirësuar këto procese nëpërmjet eliminimit të proceseve që zgjasin shërbimet në kohë, mirëpërcaktimin e workflowit të punës, përmirësimin e komunikimit ndërmjet drejtorive dhe parashikimin e ndryshimeve. Në të njëjtën kohë nëpërmjet këtij lloji standartizimi synohet të arrihen përafrimet me Standartet e Bashkimit Europian dhe përcaktimin e të gjitha elementëve ligjore që mund të kenë nevojë për përmirësim.

Qëllimi i këtij shërbimi është identifikimi dhe përmirësimi i procedurave të brendshme, cilësisë së shërbimit dhe krijimit të sistemeve për mbikqyrje të vazhdueshme të veprimeve korrigjuese. Vlerësimi i Sistemit të Menaxhimit të Procesit dhe Menaxhimit të Cilësisë dhe Trajnimi për përmirësimin e procesit dhe interpretimi i kërkesave të ISO 9001.

Rezultatet e gjeneruara nga ky proces do të jenë:

Vlerësimi i Sistemit të Menaxhimit të Procesit dhe Menaxhimit të Cilësisë

1. Përgatitja e një metodologjie për menaxhimin e procesit dhe vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë;
2. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit të procesit dhe menaxhimit të cilësisë sipas metodologjisë së përcaktuar;
3. Krijimi i raportit me dobësi të identifikuar dhe rekomandime për trajnime për përmirësimin e procesit.
4. Krijimi i një sistemi nxitës për përmirësimin e vazhdueshëm të procedurave të brendshme, cilësinë e shërbimit për identifikim dhe zbatim të veprimeve korrigjuese.

Trajnimi për përmirësimin e procesit dhe interpretimi i kërkesave të ISO 9001

1. Krijimi i një plani trajnimi gjithëpërfshirës;

2. Trajnim për Metodologjinë e Përmirësimeve të Procesit;
3. Trajnim për matjen e përmirësimeve duke përdorur Treguesit Kryesor të Performancës (KPI) të lidhur me drejtuesit e institucionit;
4. Interpretimi i kërkesave të ISO 9001;
5. Trajnim me ushtrime praktike se si të zbatohen kërkesat e ISO 9001 në organizatë;
6. Trajnimi i auditorëve të brendshëm;
7. Krijimi i raportit të vlerësimit të trajnimit;

Certifikimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë

- Kryerja e auditimit të certifikimit në përputhje me ISO 9001:2015

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Rioptimizimi dhe Standartizimi i Proceseve të punës të strukturës së institucionit të Bashkisë Tiranë”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- *Dokumentat e tenderit*
- *Termt e referencës/ specifikimet teknike*
- *Lista e shërbimeve të kërkuara*

NJËSIA E PROKURIMIT